



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:008888
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05527310

Ac.nr.6745/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Hunaida Pasuli kryetare e kolegjit, Burim Shala dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.T. nga fshati, Komuna e Lipjanit, të cilin me autorizim e përfaqëson A.H., avokat nga Drenasi, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, me objekt kontesti kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.124/20, të datës 16.08.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.124/20, i datës 16.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.124/20, të datës 16.08.2022, ka vendosur si në vijim: “ Në pikën një (I) Aprovohet në tërësi kërkesë padia e paditësit E.T. nga fshati, Komuna e Lipjanit, si e bazuar.

Në pikën dy (II) Detyrohet e paditura Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shujtave për ditët e prezencës në punë, t'ia paguaj paditësit për 831 ditë të punës për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 06.05.2022 të përlllogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë në shumën e përgjithshme prej 1,662 euro me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 16.08.2022, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Në pikën tre (III) Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 208.00 euro dhe në emër të taksës për padi shumën prej 20.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, konstatim të gabuar të gjendjes faktik dhe për shkak të shkeljes esenciale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda ti kthehet shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë përmes përfaqësuesit të tyre, ka paraqitur paditësi duke i kontestuar të gjitha pretendimet ankimore me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar dhe të detyrohet e paditura që në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë të paguaj shumën prej 208 euro sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datë 27.01.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Lipjanit -Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.124/20, të datës 16.08.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "....." -, Lipjan. Gjykata përmes vërtetimit të lëshuar nga ana e të paditurës, përkatësisht drejtori i institucionit ku paditësi punon, mbi ditët e prezencës në punë, kishte vërtetuar faktin se i njëjti gjatë vitit 2017/2022 ka qenë prezent në punë për 831 ditë pune. E paditura, paditësit nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit përkundër detyrimit që përcaktohet në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, prandaj gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia është e bazuar që në emër të kompensimit të shpenzimeve të

ushqimit për 831 ditë të pranisë në punë të ia paguaj shumën prej nga 2 euro për secilën ditë, duke ia njohur shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në Shkollën Filllore Mesme Ulët “.....”- në fshatin, Prizren. Paditësi gjatë vitit 2017/2022 ka qenë prezent në punë për 831 ditë pune, fakt ky i vërtetuar sipas vërtetimit numër 2076/2 të lëshuar nga e paditura. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësit nuk i’ a ka paguar shpenzimet e ushqimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata kishte ardhur në përfundim se kërkesëpadia është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar dhe atë për 831 ditë të pranisë në punë t’ia paguaj shumën prej nga 2 euro për secilën ditë, gjegjësisht shumën e përgjithshme prej 1,662 €.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me

paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtës, gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës me ç ‘rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 përcaktohet se: *“1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t’i përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bien të paditurën, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6745/22, me datë 28.02.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli